



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1116/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj, dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Krenare Kukleci, kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 27.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga Krenare Kukleci, kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 27.11.2017, ka pranuar një apel nga Krenare Kukleci, kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, me të cilën ka theksuar se qysh nga fillimi votat i siguronin ulësen në kuvendin komunal me rastin e numërimit duke i llogaritur ato nga posta dhe ato me kusht. Parashtruesja e apelit thekson se nga rezultatet përfundimtare të numërimit ajo ka hyre në asamble me 201 vota duke e lënë pas me 197 vota kandidaten Edona Mehanolli Lubeniqi e cila pas rinumërimit arriti rezultatin 203. Parashtruesja thekson se kjo diference prej 6 votash nga rezultatet mëparshme lë hapësirë për dyshime në lidhje me numërimin pasi që familja nga diaspora dhe nga Kosova i kanë konfirmuar votimin për të e të cilat nuk ishin llogaritur në rezultatin përfundimtar. E njëjta thekson se me se shumti ka dyshime në lidhje me qendrën e votimit 0604c në Gurakoc.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë së apelit, gjeti se:

apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Krenare Kukleci, kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, është i palejuar. Sepse KQZ ka shpallur Raportin e kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, ku nga ky rinumërim ka dal fitues Edona Mehanolli Lubeniqi, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për Komunën e Istogut me 203 vota, ndërsa ka humbur mandatin parashtruesja e apelit Krenare Kukleci kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik LDK me 201 vota.

Me dispozitën nenin 106.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Rezultatet Zgjedhore) i cili përcakton se: *“KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtresat”*. Për më tepër nuk e përcakton asnjë dispozitë ligjore të parashtrohet ankesë ndaj rezultatit që rezulton pas rinumërimit me vendimin e PZAP-it.

Prandaj, nga këto arsye arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1116/2017 me datën 27.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa